



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e Solemne e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 05.03.2026, duke filluar nga ora 10:00, në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Ftesa për këtë mbledhje ishte për nderë të 28 vjetorit të Epopesë së UÇK-së.

Mbledhja u hap me Himnin Kombëtar Shqiptar dhe Himnin e Republikës së Kosovës.

Mbledhja u kryesua nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Simir Krasniqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit, shumë të nderuar familje të dëshmorëve, të nderuar invalidë, veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar pjesëtarë të organizatave të dala nga lufta Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shumë i nderuar kryetar i komunës zoti Shaqir Totaj, nënkryetar për komunitete zoti Furkan Bytyçi, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtor të ekzekutivit, i nderuar deputet i kuvendit të Kosovës zoti Kujtim Gashi, të nderuar përfaqësues nga konsolata turke, përfaqësues nga FSK-ja, përfaqësues nga policia, Kfori turk, i nderuar ish-kryetar i komunës së Prizrenit profesor doktor Ramadan Muja, të nderuar përfaqësues të komunitetit fetar, përfaqësues të bizneseve, shoqëritë civile, media, të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në seancën solemne të ftuar për nder të 28-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju ftoj për një minutë heshtje në nderim të të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës dhe sakrificën e familjes Jashari. Lavdi! Sot në këtë seancë solemne shënojmë 28-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rezistencës heroike të familjes Jashari. Njëherësh nderojmë të gjithë heronjë, dëshmorët dhe martirët e lirisë së Kosovës. Epopeja 5, 6 dhe 7 marsit si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Kosovës. Kjo epokë simbolizon sakrificën, guximin, vendosmërinë e popullit tonë për liri. Sot, këto data të marsit, kujtohen më shumë nderim, si ditë të lavdisë dhe krenarisë kombëtare. Në këtë seancë solemne nuk duhet harruar kontributin e luftëtarëve të ish-ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të tjerët të cilët padrejtësisht po gjykohen në Hagë. Kjo epokë mbetet gur themeltar i lirisë dhe shtetësisë së Kosovës. Kemi nderin që ta dëgjojmë një fjalim rastin nga kryetari i OVL UÇK-së Dega në Prizren, zoti Isa Berisha.

Isa Berisha: Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, i nderuari kryetar i komunës zoti Shaqir Totaj, i nderuari kryesues i kuvendit komunal të Prizrenit zoti Simir Krasniqi, i nderuari ish-kryetar i komunës zoti Ramadan Muja, të nderuar përfaqësues të institucioneve lokale, drejtues të administratës, përfaqësues të mediave, përfaqësues të policisë së Kosovës, e dashur ushtria e Kosovës, të dashur qytetarë të Prizrenit dhe mbarë kombit shqiptar, parti politike, asambleist, drejtor. Sot jemi mbledhur për ta përkujtuar me krenari dhe me nder, me nderim të thellë epopenë e Jasharave 5, 6 dhe 7 marsit. Ngjarje që vulosi kthesën historike të popullit shqiptar në Kosovë dhe dha hovë të pandalshëm luftës për liri. Epopeja e Jasharëve nuk është vetëm datë në kalendarin tonë kombëtar. Ajo është simboli i qëndresës, i sakrificës dhe i vendosmërisë së një populli për të jetuar i lirë në tokën e vet. Është momenti kur liria mori emër, zë dhe mori gjak. Komandanti legjendar Adem Jashari bashkë me bacën Shaban, Hamz Jashari u bënë themel i pathyeshëm i lirisë sonë. Ata u fjuan për Kosovë duke dëshmuar para botës se shqiptarët nuk dorëzohen përballë padrejtësive dhe pushtimit. Sakrificat e tyre tronditi ndërgjegjen ndërkombëtare dhe bashkoi shqiptarët kudo që ishin me një idealë të vetëm çlirim dhe shtet ndërtim. Nga kjo sakrificë u ngrit një Ushtri Çlirimtare, e cila me guxim dhe me përkushtim mobilizoi bijtë më të mirë të këtij vendi. Lufta jonë ishte luftë për dinjitet, për barazi dhe për të drejtë dhe për të jetuar të lirë. Ishte luftë për të ardhmen e fëmijëve tonë dhe për shtetin që sot e gëzojmë. Le të jetë kjo ditë përkujtimi jo vetëm rikthim në të kaluarën, për zë i fuqishëm për drejtësi dhe dinjitet. Në këtë ditë të shenjtë kujtojmë edhe bashkëluftëtarët tanë, krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët sot po përballen me një proces gjyqësor në Hagë. Ne besojmë në drejtësi, të drejtën dhe të pa në drejtësi të drejtë dhe të paanshëm dhe jemi të bindur se lufta Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë çlirimtare e pastër dhe në mbrojtje të popullit të vet. Historia e saj nuk mund të zhbëhet, sepse është shkruar me sakrificë dhe me gjakun e dëshmorëve dhe martirëve. Sot më shumë se kur kemi obligim moral dhe kombëtar ta ruajmë unitetin, ta mbrojmë të vërtetën tonë historike dhe ta forcojmë shtetin tonë. Vlerat e UÇK-së janë themel i Republikës sonë dhe janë pjesë e pandashme e identitetit tonë kombëtar. Le të jetë kjo ditë betimi se do të qëndrojmë të bashkuar, se do të ndërtojmë sakrificën, do të nderojmë sakrificën, se do ta ndërtojmë Kosovën me drejtësi, dinjitet dhe përkushtim për brezat që do të vijnë. Në këtë përvjetorë të shenjtë përurimi me respekt para të gjithë dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të Kosovës. Lavdi e përjetshme e komandantit legjendar Adem Jashari, lavdi heroike familjes Jashari, lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar. Urime Epopeja e Jasharëve, qoftë e përjetshëm liria jonë. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, zoti Berisha. Ftojme përfaqësuesin nga Partia Demokratike e Kosovës për një fjalë rasti.

Arianit Berisha (PDK): Të nderuar familjarë dëshmorëve, invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar kryetar, nënkryetar, i nderuar kryesues, kabinet i drejtorëve, kolegë kuvendarë, të nderuar përfaqësues të policisë dhe të Ushtrisë së Kosovës, përfaqësues të bashkësive fetare, përfaqësues nga konsullata turke, i nderuar ish-kryetar i komunës zoti Ramadan Muja, i nderuar deputet, të nderuara media dhe ju të pranishëm. Jemi mbledhur në këtë seancë solemne në këtë përvjetor të lavdisë, në ditën ku 28 vite më parë filloi për herë të parë të ndjehet

aroma e lirisë, në ditën ku bota i ktheu sytë nga Kosova dhe u çudit me atë që pa. Një familje tronditi një armatë. Prandaj jo rastësisht ajo që ndodhi në Prekaz tronditi gjithë botën. Më kujtohet një rrëfim i njërit nga shokët e baci Shaban, i cili kur e përshkruan vizitën e tij të fundit te familja Jashari, kërkon nga ai që t'i largojë të paktën fëmijët. E baci Shaban ja kthen, urdhëro, futu brenda dhe nëse arrin ta bindësh vetëm njërin prej tyre që të largohet, dije që po ma hekë një barrë të madhe. Determinimi i familjes Jashari, nga Blerina shtatë vjeçe deri te nënë Zahidja e bacë Shabani 74 vjeç, nuk kishte të bënte vetëm me atë ditë. Nuk kishte të bënte as vetëm me jetën e tyre, sepse atë ditë po përcaktohej fati i një kombi që kaloi shekuj i robëruar. Atë ditë po përcaktohej liria e shtetësia që sot e gëzojmë të gjithë. 59 heronj, secili më i madh se tjetri për nga madhështia, morën mbi supe barrën e një kombi, duke i treguar botës që liria është më e shtrenjtë se jeta. Një luftë e pabarabartë jo vetëm nga aspekti ushtarak, por edhe nga ai emocional. Baca Ademi e baca Hamz nuk i ndalën pushkët edhe kur fëmijët e tyre po vriteshin një e nga një, deri në plumbin e fundit, deri në frymën e fundit. Para më shumë se 30 vitesh vizionari Hamz Jashari në një video inçizim deklaronte: Këtu do ta bëjmë vdekjen. Kjo tokë s'e duron tjetërkënd vetëm këmbën e shqiptarëve. Ata e dinin saktë se çfarë duhej bërë dhe nuk kursyen asgjë nga vetja. Dikush sot mund të habitet se si ndodhi gjithë ajo lavdi, por ata e kishin të shkruar fatin e tyre. Prandaj u bën simbol qëndrese e u bën flakadan i pashuar i lirisë, duke frymëzuar djemtë e vajzat më të mira të këtij kombi për të vazhduar luftën deri në flijim. Ata janë frymëzim edhe sot, e të tillë do të jenë sa të jetë jeta. Një lutje për të gjithë duke filluar së pari me veten t'i kujtojmë këto sakrifica çdo ditë, para çdo vendimi e veprimi tonin. E mos ta ndalim asnjëherë kontributin për këtë tokë, e cila është e larë me gjak në çdo pëllëmb të saj. Urime të gjithëve ky përjetor i lavdisë, nderime për jetë dëshmorëve të kombit dhe të gjithë atyre që dhanë të paktën diçka nga vetja që ta gëzojmë lirinë dhe për këtë tokë të shenjtë. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, vazhdojmë me përfaqësuesin nga Lëvizja Vetëvendosje. Për një fjalë rasti.

Nerimane Pllana Gashi (LVV): Të nderuar të pranishëm, ju të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë të luftës, veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shoqata të dala nga lufta, përfaqësues të Ushtrisë dhe Policisë së Kosovës, shumë të respektuar kolegë kuvendarë të Kuvendit të Prizrenit. Sot jemi mbledhur për të përkujtuar ditët më të rëndësishme të historisë tonë, Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, aty ku u vu themeli i shtetit dhe identitetit tonë, epopeja gjithmonë na qonë në Prekaz. Aty ku qëndresa u kthy në simbol të përjetshëm të lirisë, na qonë te figura e ndritshme e Adem Jasharit, na qonë te sakrifica sublime e familjes së tij. Një familje që zgjodhi të mos përkulet, por të bëhet themel i lirisë sonë. Ata nuk luftuan për lavdi personale, por për dinjitet kombëtar. Ata nuk u dorëzuan përballë dhunës, por u shndërruan në dritë shprese për një popull të tërë. Sot përulemi me respekt të thellë para të gjithë dëshmorëve të rënë. Nderim i veçantë u takon invalidëve të luftës, atyre që mbajnë në trup plagët e atdheut. Çdo shenjë në trupin e tyre është dëshmi e çmimit të lirisë. Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është vetëm një përvojtor. Është përgjegjësi për thirrje, për unitet, për kujtesë që lirinë ta mbrojmë me drejtësi, me punë të

ndershme dhe me përkushtim ndaj shtetit tonë. Andaj, lavdi familjes së dëshmorit legjendar Adem Jashari, lavdi të gjithë të rënëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Ju ftoj përfaqësuesin nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për një fjalë rasti.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Të nderuara shoqatat të dalura nga lufta, i nderuar kryetar, deputet, polici e Kosovës, ushtri, ish-kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, shumë të respektuar mysafir. Ne si popull i shumëvujtur kemi shumë data kujtuese. Kemi histori krenarie dhe dhimbjeje, betejash dhe trimërie. Datat 5, 6 dhe 7 mars janë datat e kthesës së madhe të vendit tonë të bekuar. Këto data shënojnë epope në e UÇK-së në momentin kur sakrificat u shndërruan në dritë lirie. 5, 6 dhe 7 marsi ishte fillimi i fundit të një okupatori që njihte vetëm dhunën dhe çnjerëzimin. Ishte dita kur pushka e lirisë jehoi më fort se frika. Sot kujtojmë dëshmorët dhe martirët tanë që dhanë më të shtrenjtën jetën e tyre. Kujtojmë mundin, torturën dhe sakrificën e qindra mijëra shqiptarëve të përndjekur vetëm pse ishin shqiptarë dhe pse donin liri. Kujtojmë ata që ditën ta kërkojnë dhe ta mbrojnë lirinë e pavarësinë e Kosovës. Kujtojmë familje atdhetare e lirisdashëse si familja Jashari dhe shumë familje tjera, luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që u bënë themel i shtetit tonë. Kujtojmë për të mos harruar, kujtojmë për të mos u dorëzuar kurrë, kujtojmë për të çmuar lirinë që sot e gëzojmë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit dhe martirëve!. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, vazhdojmë me përfaqësuesin nga Bashkimi Demokratik. Fjala për ju.

Shukri Quni (BDP): Të nderuar familjarët e dëshmorëve, të nderuar invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar kryetar i komunës zotëri Shaqir Totaj, i nderuar ish-kryetar i komunës për tre mandate profesor doktor Ramadan Muja. Ju faleminderit që të gjithë ju që vini dhe na respektoni këtu. I nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë, drejtorë, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës, pasardhëse e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Kforit, përfaqësues të Bashkësive Fetare, media, shoqëritë civile, të nderuar të pranishëm. Sot në këtë seancë solemne, jemi mbledhur për të përkujtuar epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ngjarjen më madhore të historisë sonë të re, e cila u zhvillua me 5, 6 dhe 7 mars 1998 në Prekazin legjendar. Aty ku u vulos përjetësisht rruga e lirisë së Kosovës. Në këto ditë të shenjta për kombin tonë, familja Jashari, e udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, i dha botës shembullin më të lartë të sakrificës dhe qëndresës. Për një qëndresë përballë forcave pushtuese kriminale serbo-sllave, ku familja legjendare zgjodhi që ajo të mos dorëzohet, por të luftojë dhe të qëndrojë deri në flajm. Duke u shëndërruar në simbol të pavdekshëm të lirisë dhe dinjitetit kombëtar. Lufta heroike e familjes Jashari nuk ishte vetëm mbrojtje e pragut të shtëpisë, siç i thoshin në një kohë, por ishte akt i vetëdijshëm i sakrificës për atdheun. Aty luftuan burra, gra, pleq e fëmijë, dhe qëndruan të bashkuar duke dëshmuar se liria është vlera më e shtrenjtë për të cilën sakrifkohet gjithçka, pra dhe jeta. Nga Prekazi u dëgjua zëri i madh i kushtrimit për liri. Aty u dha pra kushtrimi për liri, i cili e mobilizoi mbarë popullin

shqiptar dhe i forcoi radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke shndërruar rezistencën çlirimtare në një luftë të përgjithshme për çlirimin e Kosovës. Ndërsa sot, ata të cilët luftuan, ata të cilët themeluan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, mbahen padrejtësisht peng në një gjykatë, ta quaj kështu, pa kurrfarë vlere. Epopeja e UÇK-së është themeli i shtetit tonë, ajo na obligon që lirinë e fituar me gjakun e dëshmorëve ta ruajmë me përgjegjësi, ta forcojmë shtetin e Kosovës dhe të punojmë çdo ditë për paqe, për siguri, drejtësi dhe zhvillim të shtetit. Sot, me nderim të thellë, përhulemi para sakrificës së familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe martirëve që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Duke u zotuar se ideali i tyre do të jetojë përherë në ndërgjegjen tonë kombëtare. Lavdi e përjetshme komandantit legjendar Adem Jashari. Lavdi familjes Jashari. Lavdi të gjithë dëshmorëve që ranë për shtetin edhe për Kosovën që sot ne e gëzojmë këtë liri. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Vazhdojmë me përfaqësuesin nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Agim Muqaj (AAK): Përshëndetje. Së pari dëshiroj ta përshëndes profesor doktor Ramadan Mujën, ish-kryetarin e komunës i Prizrenit. Të nderuar përfaqësues të FSK-së, policisë, i nderuar deputet i parlamentit zotëri Kujtim Gashi, i nderuar Totaj, i nderuar Isë Berisha kryetari i veteranëve, i nderuar Burim Shala kryetar i shoqatës së invalidëve të Lutës, i nderuar Xhevit Berisha, kryetar i shoqatës së familjeve dëshmorëve, mysafirë të nderuar, qytetarë të nderuar. Të nderuar kolegë të kuvendit të Prizrenit, sot me përlulësi dhe krenari të thellë përkujtojmë një nga kapitujt më të lavdishëm të historisë sonë, epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës 5, 6 dhe 7 mars 1998. Ditët kur doli hapur në skenë zëri i lirisë së Kosovës. Në ato ditë të marsit në Prekaz, u dëgjua krisma që nuk kishte vetëm jehonë e pushkë, por ishte kushtrimi i një populli të tërë për liri, ishte momenti kur sakrificë u bë betim, kur qëndresa u bë themeli i shtetit dhe kur guximi u bë frymë e një kombi. Familja e komandantit legjendar Adem Jashari u bë simbol i pavdekshëm i rezistencës, rënia heroike e tij dhe e familjes Jashari nuk ishte fundi, ishte vetëm fillimi, i një epoke të re, ishte mesazhi se liria ka çmim, por robëria ka kosto edhe më të rëndë. 5, 6 dhe 7 marsi nuk janë thjesht data kalendarike. Ato janë themeli mbi të cilat, u ndërtua rruga jonë drejt pavarësisë. Janë dëshmi se kur një popull bashkohet rreth idealet e lirisë, asnjë forcë nuk mund ta ndalë. Sot ne si përfaqësues të qytetarëve kemi detyrë ta ruajmë amanetin e tyre që ranë për liri, të cilët u flijuan, nuk është vetëm territor, është drejtësi, është barazi, është shtet ligjor, është dinjitet për çdo qytetar. Le të jetë ky përvjetor jo vetëm ditë kujtimi, por ditë reflektimi dhe zotimi. Zotimi që do ta forcojë shtetin, do ta ruajë unitetin dhe do të punojë me ndjeshmëri për brezat që vijnë. Sepse gjaku i dëshmorëve nuk na thërret për përçarje, na thërret për bashkim, nuk na thërret për urrejtje, na thërret për ndërtim, nuk na thërret për fjalë të mëdha, por për vepra të mëdha. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Muqaj. Vazhdojmë me përfaqësuesin nga komuniteti turk.

Sevilay Igci Hapçi (KDTP): Sayın Belediye Başkanı, belediye başkan yardımcıları, meclis başkanı, bir önceki dönem belediye başkanı, müdürlerimiz, meclis üyelerimiz, Kosova Polisi, Kosova Askeriyesi, UÇK gazileri başkanı, şehit aileleri ve gazilerimiz, basın mensupları ve bütün Prizrenli hemşerilerimiz hepinizi saygıyla selamlıyorum. 5-6-7 Mart günleri Kosova'nın özgürlük mücadelesinin simgesi olan KKO (UÇK) günleri olarak anılmaktadır. Bu günler halkımızın özgürlük ve bağımsız uğuruna verdiği mücadelenin ve gösterdiği fedakârlığın hafızalarda canlı tutulduğu günlerdir. 1998 yılında Prekaz'da yaşanan olaylar sırasında Sırp güçleri ile UÇK arasında çatışmalar yaşanmış bu çatışmalarda Adem Jashari ve Jashari ailesinin birçok ferdi hayatını kaybetmiştir. Bu olay Kosova'nın özgürlük mücadelesinde bir dönüm noktası olmuş ve halkımızın direniş ruhunun sembolü haline gelmiştir. Onların gösterdiği cesaret, kararlılık, fedakârlık bugün sahip olduğumuz barışın, özgürlüğün ve birlikte yaşamanın iradesinin temelini oluşturmaktadır. Başta Adem Jashari ve Jashari ailesi olmak üzere özgürlük ve bağımsızlık uğuruna hayatını feda eden tüm şehitlerimizi saygı, minnet ve rahmetle anıyoruz. Aynı zamanda bu mücadeleye yer alan gazilerimize de şükranlarımızı sunarız. Teşekkür ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Vazhdojmë me përfaqësuesin nga komuniteti boshnjak.

Eldis Abazi (Vakat):

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Dhe në fund kemi nderin ta dëgjojmë fjalimin nga kryetari i komunës së Prizrenit, zoti Shaqir Totaj.

Shaqir Totaj (Kryetar): I nderuari kryesues i kuvendit, të nderuar asambleistë, të respektuar familjarë të dëshmorëve, veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar mysafirë dhe qytetarët të Prizrenit, të nderuar përfaqësuesit të Policisë së Kosovës, të FSK-së, i nderuari zoti Ramadan Muja, një përshëndetje të veçantë. Po ashtu përshëndesim edhe konzulin e Republikës Turke. Edhe mos ta harrojmë najkon se zakonisht e harroj najkon po s'e besoj. Sot jemi mbledhur në këtë seancë solemne për të përkujtuar epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një nga momentet më të thella të historisë sonë moderne, një moment ku dhimbja dhe madhështia e sakrificës u bashkua në një kapitull të pavdekshëm të kujtesës sonë kombëtare. Datat 5, 6, 7 mars nuk janë vetëm një kujtesë e një beteje. Ato janë një kujtesë e një vendimi madhor njerëzor, vendim për të mos u dorëzuar përballë padrejtësisë. Në atë ditë të marsit të vitit 88 në Prekaz familja e komandantit legjendar të Adem Jasharit së bashku me vëllanë e tij Hamzën dhe familjet e tyre u bënë simbol i një qëndrese që tejkalon kohën. Ata nuk zgjedhën rrugën më të lehtë. Ata zgjedhën rrugën e dinjitetit. Dhe pikërisht për këtë arsye historia e tyre nuk është vetëm histori lufte, është histori e karakterit njerëzor. Sepse në thelb çdo epike fillon me një pyetje të thjeshtë. Çfarë vlen më shumë, jeta pa liri apo sakrifica për të jetuar të lirë? Në Prekaz përgjigja u dha me guxim. Sot kur e përkujtojmë atë sakrificë duhet të kuptojmë se epikeja nuk është vetëm e kaluar. Ajo është një mesazh për të ardhmen. Liria nuk është vetëm një moment historik, është një obligim dhe përgjegjësi e përditshme. Brezi që luftoi për liri na dha mundësinë të ndërtojmë një shtet. Por brezi ynë ka një detyrë tjetër, ta mbushë këtë liri me kuptim, të mbushë me drejtësi, me zhvillim, me

dinjitet për çdo qytetar. Sepse sakrificat e dëshmorëve nuk kërkon vetëm përkujtim. Ajo kërkon përkushtim. Nëse ata dhanë jetën për liri, ne duhet të japim përkushtimin tonë për një shoqëri më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të bashkuar. Prizreni është një qytet që e njeh mirë historinë, është një qytet ku brezat kanë ndërtuar ura mes së kaluarës dhe të së ardhmës. Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit deri te përpjekja për çlirimin e Kosovës, ky qytet ka qenë gjithmonë një hapësirë ku historia nuk është vetëm kujtesë, por edhe frymëzim. Dhe ndoshta pikërisht kjo është filozofia më e thellë e epopesë së UÇK-së. Se liria nuk është vetëm rezultat i guximit të disa njerëzve të jashtëzakonshëm. Ajo është rezultat i besimit të një populli të tërë. Një popull që edhe në momentet më të vështira nuk e humbi shpresën. Sot brezat e rinj rriten në një Kosovë të lirë. Ata nuk e kanë përjetuar luftën, por kanë një detyrë po aq të rëndësishme të kuptojnë vlerën e lirisë. Sepse liria që nuk kuptohet rrezikon të merret si e mirëqenë. Ndaj detyra jonë është që historinë ta ruajmë, por edhe ta tregojmë. Jo vetëm si histori dhimbje, por si histori dinjiteti. Sepse epopeja e vërtetë nuk është vetëm me sakrificë. Epopeja e vërtetë është kur një popull arrin të ndërtojë të ardhme mbi kujtesën e sakrificës. Të ardhme jo vetëm për shqiptarët, për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë. Sot ne nuk jemi këtu vetëm për të kujtuar. Jemi këtu për të reflektuar. Të reflektojmë se çfarë shteti duam të ndërtojmë. Çfarë shoqërie duam t'u lëmë brezave që vijnë. Sepse historia na ka mësuar një gjë të madhe. Liria fitohet me sakrificë, por ruhet me mençuri. Prandaj sot duke përkujtuar dhe epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, le të përulemi me respekt para të gjithë dëshmorëve të kombit dhe para familjeve që mbajnë mbi supet peshën e kësaj sakrificë. Dhe njëkohësisht të bëjmë një premtim të thjeshtë por të madh, se do të ndërtojmë Kosovën me përgjegjësi, me unitet dhe me besim për të ardhmen më të mirë. Sepse kjo është mënyra më e denjë për të nderuar sakrificën e atyre. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit, lavdi epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju falenderoj për vëmendjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit i nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, ju faleminderit shumë për pjesëmarrjen dhe mirupafshim në seancat tjera të radhës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi

